

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031) si dhe në nenin 21 të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit të Kompanisë Rajonale Ujësjetlësi “Mitrovica” Sh.A. në Mitrovicë, duke u bazuar në kompetencat e dhëna me aktet e brendshme të Kompanisë Rajonale Mitrovica Sh.A, Kryeshefi Ekzekutiv i kësaj Kompanie, me seli në Mitrovicë, më datë 09.03.2026, nxjerr këtë vendim:

### V E N D I M

- I. Anulohet Konkursi për pozitën **Shef/e i/e mirëmbajtjes së rrjetit të ujit dhe kanalizimit – në Njësitë Operative**, për vendet e punës në **Mitrovicë Veriore (1), Zubin Potok (1) dhe Leposaviq (1)**, i publikuar në ueb faqen zyrtare të kompanisë si dhe në portalet elektronike me datë **23.01.2026**, për plotësimin e vendeve të lira të punës.
- II. **OBLIGOHET**, Zyra e Burimeve Njerëzore të njoftoj Kandidatët që kanë aplikuar lidhur me këtë vendim.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Kryeshefi Ekzekutiv, i Kompanisë Rajonale Ujësjetlësi “Mitrovica” Sh.A. në Mitrovicë, ka marrë vendim për Anulimin e Konkursit për pozitën Shef/e i/e mirëmbajtjes së rrjetit të ujit dhe kanalizimit – në Njësitë Operative, për vendet e punës në Mitrovicë Veriore (1), Zubin Potok (1) dhe Leposaviq (1), i publikuar në ueb faqen zyrtare të kompanisë si dhe në portalet elektronike me datë 23.01.2026, duke pasur parasysh se për pjesën veriore kërkohet domosdoshmërisht njohja e dy gjuhëve, për shkak të përbërjes multietnike të popullsisë dhe nevojës për komunikim të efektshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë dhe veprojnë në atë zonë si dhe komunikimit të vazhdueshëm me Menaxhmentin dhe Zyrtaret e kompanisë, kjo kërkesë konsiderohet thelbësore për ofrimin e shërbimeve cilësore, për respektimin e të drejtave gjuhësore si dhe për funksionimin sa më efikas të institucionit.

Duke qenë se këto kritere dhe kërkesa specifike nuk janë reflektuar në mënyrë të mjaftueshme në konkursin aktual, vlerësohet se vazhdimi i tij në formën ekzistuese mund të mos garantojë përzgjedhjen e kandidatëve që i plotësojnë në mënyrë adekuate kushtet dhe kërkesat e nevojshme për secilën zonë.

Për këto arsye, vendoset anulimi pjesërisht i konkursit aktual, Konkursat e anuluar do të rishpallen në përputhje me rregullat dhe afatet ligjore, pjesa tjetër e konkursit do të vazhdojë të zhvillohet sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara.


Bazuar në gjetjet dhe arsyet e mësipërme, vendimi merret siç përcaktohet në pjesën dispozitive të këtij Vendimi.

**Vendimi i dërgohet:**

1 x arhives

1x burimeve njerzore

Kryeshefi Ekzekutiv



Bashkim Kurti



Na osnovu člana 53 Zakona o Opštem Ppravnom Postupku (Br. 05/L-031), kao i člana 21 Pravilnika o Procedurama Rekrutovanja Kompanije Regionalni Vodovod „Mitrovica“ A.D. u Mitrovici, zasnivajući se na ovlašćenjima datim internim aktima Kompanije Regionalni Vodovod „Mitrovica“ A.D., Izvršni direktor ove Kompanije, sa sedištem u Mitrovici, dana 09.03.2026. godine donosi sledeću:

### ODLUKU

I. Poništava se konkurs za poziciju **Šef/ica održavanja vodovodne i kanalizacione mreže - u Operativnim Jedinicama**, za radna mesta u **Severnoj Mitrovici (1), Zubin Potoku (1) i Leposaviću (1)**, objavljen na zvaničnoj veb stranici kompanije kao i na elektronskim portalima dana **23.01.2026. godine**, za popunjavanje slobodnih radnih mesta.

II. OBAVEZUJE SE Kancelarija za Ljudske Resurse da obavesti Kandidate koji su aplicirali u vezi sa ovom odlukom.

III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

### Obrazloženje

Izvršni Direktor Kompanije Regionalni Vodovod „Mitrovica“ A.D. u Mitrovici doneo je odluku o poništavanju konkursa za poziciju **Šef/ica održavanja vodovodne i kanalizacione mreže - u Operativnim jedinicama**, za radna mesta u **Severnoj Mitrovici (1), Zubin Potoku (1) i Leposaviću (1)**, objavljenog na zvaničnoj veb stranici kompanije kao i na elektronskim portalima dana **23.01.2026. godine**, imajući u vidu da je za severni deo neophodno poznavanje dva jezika, zbog multietničkog sastava stanovništva i potrebe za efikasnom komunikacijom sa svim zajednicama koje žive i deluju u toj oblasti, kao i zbog kontinuirane komunikacije sa Menadžmentom i službenicima kompanije. Ovaj uslov se smatra suštinskim za pružanje kvalitetnih usluga, za poštovanje jezičkih prava, kao i za što efikasnije funkcionisanje institucije.

S obzirom da ovi kriterijumi i specifični zahtevi nisu u dovoljnoj meri reflektovani u aktuelnom konkursu, procenjuje se da njegovo dalje sprovođenje u postojećem obliku ne bi garantovalo izbor kandidata koji adekvatno ispunjavaju potrebne uslove i zahteve za svaku zonu.

Iz tih razloga odlučuje se o **delimičnom poništavanju** aktuelnog konkursa. Poništeni konkursi će biti ponovo raspisani u skladu sa pravilima i zakonskim rokovima, dok će se preostali deo konkursa nastaviti sprovođiti prema utvrđenim pravilima i rokovima.

Na osnovu gore navedenih nalaza i razloga, odluka se donosi kao u dispozitivnom delu ove Odluke.

**Odluka se dostavlja:**

1x Arhivi

1x Kancelariji za ljudske resurse

**Izvršni direktor**

  
**Bashkim Kurti**

